



574/  
26.2.24

Nr.1810/206Prot.

Tiranë, më 23.02.2024

**NGA:** Znj. Anita Shushku

**Shoqata “Albanian Renewable Energy Association” (AREA)**

**Kryetare e Bordit.**

**DREJTUAR:** Z. Petrit Ahmeti

**Kryetar**

**Enti Rregullator i Energjisë**

**OBJEKTI:** Kthim përgjigje tuajës nr.574 prot, datë 05.02.2024

I nderuar Z. Ahmeti,

Në vijim të shkresës tuaj “*Njoftim Vendimi nr.377, datë 28.12.2023*” nr.574 prot, datë 05.02.2024, lidhur me “*Draft Metodologjinë mbi Përcaktimin e Detyrimit për Energjinë e Rinovueshme për t'u Paguar nga Konsumatorët Fundorë të Energjisë Elektrike*” (në vijim “Medotologjia”), po ju paraqesim komentet tona lidhur me këtë metodologji:

1-Në tërësinë e saj mendojmë se vendimi për të vendosur detyrimin e pagesës për energjinë e rinovueshme te të gjithë konsumatorët fundorë përfshirë edhe ata që furnizohen në treg të lirë është një hap pozitiv.

Megjithatë ne shohim me shqetësim zhvendosjen e MBE drejt OER dhe mekanizmin e mbledhjes së fondeve prej OER. Ky shqetësim lidhet edhe me eksperiencën e mëparshme të Prodhuves me Përparësi kur MBE paguhej nga KESH. Kalimi i kontratës me OSHE dhe më pas me FTL ka rezultuar si vendimi më i mirë në lidhje me menaxhimin e pagesave, akteve të rakordimit të prodhimit mujor, etj. Për këtë mendojmë që procesi i kalimit të MBE te OER të bëhet pasi OER të konsolidohet si institucion, duke u njojur së pari me prodhimin, fluksin, disbalancat, problemet që hasin prodhuesit gjatë operimit si ndërprerjet etj dhe pastaj gradualisht të vendoset për kalimin e kontratave të shitblerjes apo jo. Ne shpresojmë që struktura tashmë me shumë eksperincë e FTL të jetë bërthama e OER, për ta bërë kalimin sa më të lehtë.

2-Neni 4, pika 6, thotë OER “ka përgjegjësinë e mbledhjes... së të dhënave ..si dhe mbështetjen në lidhje me përgjegjësinë balancuese për PP që janë të përjashtuar.. “ndërkohë që aktualisht askush nga prodhuesit nuk është i përjashtuar. A do jetë ky një lajm i mirë që disa nga prodhuesit të jenë të përjashtuar? (ato me kapacitet nën 2MW të paktën).

3-Neni 4, pika 8 dhe 9 prezumon se disa MBE të PP kanë një kufi për vlerën e pagueshme të disbalancave. A do ketë ndryshime në lidhje me përgjegjësinë për disbalancat për PP?

4- Neni 4, pika 11, mendojmë se vendosja e përgjegjësisë së parapagimit për furnizuesit në thelbështë e padrejtë dhe kjo mund ta cënojë edhe pagesën në afat të PP nga ana e OER. Ne mendojmë se është shumë e rëndësishme që të vendosen detyrime të arsyeshme për të gjithë pjesmarrësit e tregut, kjo si bazë e rëndësishme që të mos rrezikohen arritjet e deritanishme si psh ajo e pagesave në kohë e energjisë së prodhuar nga PP. Parashikimi i vështirësive financare të OER është shqetësuese për PP dhe për këtë kërkojmë të diskutohet në një seancë dëgjimore mbi analiza të detajuara se ku mbështetet mundësia e kësaj rrethane (të pamundësisë së pagimit).

5. Neni 6, pika 1, që kërkon që PP në operim si dhe PP të cilët planifikojnë të vënë në funksion impiantet e tyre në Vitin pasardhës ti dërgojnë *OER para datës 1 Shtator* një parashikim vjetor mendojmë se nuk do të realizojmë marrjen e të dhënavë të sakta. Ne mendojmë se prodhuesit të vazhdojnë të dërgojnë parashikimet para datës 30 Nëntor ku pjesa më e rëndësishme janë të dhënat për gadishmérinë e parashikuar të impianteve se sa parashikimi i prodhimit bazuar në parashikimin e motit sepse kjo është praktikisht e pamundur. Parashikimi mund të përpilohet vetë nga OER bazuar nga të dhënat shumëvjecare të prodhimit të hec-eve.

6- Neni 7, llogaritja e detyrimit nuk është plotësisht e qartë dhe kërkojmë për këtë por edhe për sa më sipër të diskutohet dhe sqarohen cështjet në një seancë dëgjimore me përfaqësues të gjithë faktorëve të tregut që preken.

AREA, propozon që tarifa të jetë e pandryshuar me një afat të paktën 1 vjecar.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin, shpresojmë të merren në konsideratë komentet tonë dhe të organizohet seanca dëgjimore.

Me konsideratë,

**SHOQATA “AREA”**

Anita Shushku

